



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

Nr. 1463 Prot. IKTK  
Tiranë, më 01.09. 2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

SHËRBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR

Nr. 1209 Prot. SHGJSH  
Tiranë, më 30.08. 2022

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

INSTITUTIT KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË KULTURORE

dhe

SHËRBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR

"PËR

*ZHVILLIMIN E PROJEKTEVE DHE VEPRIMTARIVE TË PËRBASHKËTA LIDHUR  
ME STUDIMET NË FUSHËN E GJEOSHKENCAVE PËR OBJEKTET PASURI  
KULTURORE"*

Sot më datë 01.09. 2022, në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore-Tiranë, lidhet kjo marrëveshje e bashkëpunimit, ndërmjet palëve:

**Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore** me adresë Rruga "Aleksandër Moisiu", nr. 76, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Znj. Rudina Zoto dhe

**Shërbimit Gjeologjik Shqiptar** me adresë Rruga "Myslym Keta", Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Z. Viktor Doda.

Në këtë marrëveshje emrat e institucioneve kanë këto shkurtime :

- IKTK - Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore;
- SHGJSH - Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.

Duke qenë se:

1. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), Ministria e Kulturës, është institucioni kryesor përgjegjës për ruajtjen, mbrojtjen, konservimin, restaurimin, promovimin dhe vlerësimin e monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore materiale në territorin e Republikës së Shqipërisë. IKTK nëpërmjet bashkëpunimit me institucione të specializuara merr të gjitha masat që sigurojnë gjurmimin, hulumtimin,

mbrojtjen, dokumentimin, konservimin, restaurimin shkencor dhe promovimin e objekteve, monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore dhe

2. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ushtron aktivitetin e tij në fushën e gjeoshkencave, ka statusin juridik si “*institucion këshillimor, teknik dhe shkencor i shtetit, person juridik publik, buxhetor, i cili kryen veprimtari në fushën e shkencave të tokës në territorin e Republikës së Shqipërisë*”;

palët bien dakord si më poshtë vijon:

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është rritja e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet dy institucioneve në fusha me interesa të përbashkëta.

Nëpërmjet kësaj Marrëveshje bashkëpunimi palët angazhohen të ndërmarrim studime dhe projekte te përbashkëta në fushën e trashëgimisë kulturore, për ruajtjen, mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin shkencor të vlerave të trashëgimisë kulturore materiale në territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllim lehtësimin e procedurave për kontributet institucionale në raste bashkëpunimesh si dhe për të hapur rrugë për bashkëpunime të mëtejshme

### **Neni 2**

#### **Objekti**

Objekti i kësaj Marrëveshje është përcaktimi i mënyrave të bashkëpunimit ndërmjet palëve lidhur me studime gjeologjike për objektet pasuri kulturore me interes brenda fushës së përgjegjesisë së IKTK-së dhe SHGJSH-së.

### **Neni 3**

#### **Baza ligjore**

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hartohet duke u bazuar në:

- Ligjin 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë";
- Statutin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore;
- Ligjin Nr. 111/2015, datë 15.10.2015, “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”;
- Statutin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.
- Në Rregulloren “Për Funkcionimin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”, të miratuar me Urdhër Nr. 88, datë 22.02.2016, nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë.

### **Neni 4**

#### **Roli dhe detyrimet e palëve**

Palët nëpërmjet kësaj Marrëveshje angazhohen që:

1. SHGJSH në projektet që zhvillon e drejton me fokus në fushën e trashëgimisë kulturore do të bashkëpunojë me specialistët e IKTK-së në fazat e përgatitjes, realizimit, specializimit, hartimit dhe publikimit të përfundimeve.
2. IKTK dhe SHGJSH caktojnë koordinatörë përgjegjës për ndjekjen e projekteve konkrete, si dhe caktojnë staf teknik si pjesë e grupeve të punës me detyra të përcaktuara, në fillim të çdo projekti.

3. Në zbatim të projekteve të përbashkëta të cilat përfshijnë ndërhyrje në pasuritë kulturore, çdo procedurë do të realizohet në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore për miratimin paraprak nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale.
4. IKTK dhe SHGJSH, bazuar në projektet e përbashkëta angazhohen të organizojnë aktivitete tekniko-shkencore dhe të publikojnë rezultatet e kërkimit në revistat "Monumentet", "Buletini i Shkencave Gjeologjike" ose në revista të tjera të specializuara.
5. Palët bien dakord që rezultatet e kërkimeve, i gjithë informacioni i rëndësishëm dhe njohuritë e fituara prej projekteve të përbashkëta, do të shpërndahen e publikohen ose do të mbahen konfidenciale në përputhje me termat specifike të caktuara nga të dyja palët për projekte të veçanta. Kjo mënyrë veprimi dhe mbrojtja e pronësisë intelektuale duhet të jenë në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

#### **Neni 5**

#### **Gjuha e komunikimit**

Gjuha e komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit është gjuha shqipe.

#### **Neni 6**

#### **Komunikimi mes palëve**

1. Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre, sipas kushteve të paracaktuara. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike;
2. Shkëmbimi i informacioneve do të bëhet në respekt të bazës ligjore në fuqi;

#### **Neni 7**

#### **Burimet e Financimit**

1. Në rast bashkëpunimi në projekte kombëtare ose ndërkombëtare financimi do të bëhet nga financuesi apo drejtuesi i projektit, ku secila palë merr përgjegjësitë dhe angazhimet e veta me shkrim. Palët mund të aplikojnë së bashku në këto raste edhe si një palë e vetme.

#### **Neni 8**

#### **Përlllogaritja e kostove**


Kostot financiare që rezultojnë nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje i nënshtrohen legjislacionit në fuqi dhe janë brenda kufijve të shpenzimeve buxhetore që palët kanë në dispozicion.

Marrëdhëniet financiare për të gjitha shërbimet e kryera nga palët në marrëveshje do të diskutohen dhe zgjidhen rast pas rasti, bazuar në ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe aktet e tjera ligjore që realizojnë menaxhimin financiar shërbimet/të ardhurat/tarifat/shpenzimet buxhetore, etj., të palëve në marrëveshje, nga grupet e përbashkëta të IKTK-së dhe SHGJSH-së.

#### **Neni 9**

#### **Vlerësimi i zbatimit të Marrëveshjes**

1. Palët marrin përsipër të vlerësojnë bashkërisht funksionimin e bashkëpunimit në mbështetje të Marrëveshjes nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes së raporteve periodike pranë titullarëve të Palëve.



2. Raporti periodik përmban, krahas të dhënave për mënyrën e zbatimit të Marrëveshjes, edhe rekomandimet konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara.

#### Neni 10

##### Ndryshimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

#### Neni 11

##### Përfundimi i Marrëveshjes

1. Marrëveshja e Bashkëpunimit lidhet për një afat 3 (tre) vjeçar, por mund të përfundojë në çdo kohë me kërkesën me shkrim te secilës Palë, 30 dite përpara përfundimit.
2. Deri në përfundim të kësaj Marrëveshje, palët i përmbahen kushteve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, për sa i përket informacionit, shërbimeve të ofruara dhe dokumentacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit.
3. Pavarësisht përfundimit të Marrëveshjes, kontratat e nënshkruara zbatohen deri në përfundimin e tyre.

#### Neni 12

##### Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Marrëveshjes

1. Palët marrin aprovimin e Ministrive përkatëse për këtë Marrëveshje Bashkëpunimi;
2. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët dhe është e vlefshme për një periudhë tre-vjeçare.
3. Palët zotohen se do ta zbatojnë me mirëbesim dhe me vullnet të plotë këtë Marrëveshje.

#### Neni 13

##### Dispozitat e fundit

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale, nga dy për secilën palë.

**INSTITUTI KOMBËTAR  
I TRASHËGIMISË KULTURORE**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Rudina ZOTO**



**SHËRBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Viktor DODA**

